



19.04.2019

Fondi për Zhvillimin e Komunitetit si Përfituesi Kryesor i Granteve të Fondit Global për zbatimin e Programeve të HIV-it dhe Tuberkulozit në Kosovë shpall:

RI-SHPALLJE
Vend pune për pozitën
Shofer/e për Njësinë Mobile

I raporton: Zyrtarit të Logjistikës, Programi HIV/TB, CDF
Pozitë me orar të plotë (40 orë për javë)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Shoferi/ja për Njësinë Mobile ka për detyrë dhe është përgjegjës/e:

- për ngasjen dhe mbikqyrjen e automjetit/Njësisë Mobile;
- të jetë çdoherë një orë para nisjes në vendin e punës, përkatësisht në Njësinë Mobile;
- të kontrollojë gjendjen e automjetit para nisjes në terren: furnizimi me karburante, mbushjen dhe pastrimin e cisternës së ujit, mirëmbajtjen e klimës;
- të raportojë aksidentet eventuale dhe të evidentojë çdo gjë që ka të bëjë me automjetin si psh: gërvishtjen, antenën, gomën rezervë, si dhe çdo aksesor tjetër të automjetit;
- të bëjë përcjelljen e shpenzimeve të karburanteve dhe të gjitha shpenzimet e tjera (autolarjet, servisimet etj.) të automjetit;
- të bëjë pranimin dhe procedimin e faturave të furnizimit me karburantë, servisimit, larjes dhe shpenzimeve tjera të automjetit;
- t'i përmbahet Ligjin për Komunikacion;
- të kryej detyrat në pajtim me rregulloren në fuqi mbi përdorimin e automjeteve të CDF;
- të respektoj orarin e vozitjes në vendet e caktuara me plan;
- të kontrollojë dhe të parandalojë keqpërdorimin e automjetit;
- të jetë bashkëpunues me stafin e Njësisë Mobile;
- të kujdeset për sigurinë e stafit të Njësisë Mobile;
- të dërgojë automjetin në vendparkingun e IKSHPK-së pas përfundimit të turnit të punës;
- të jetë i/e gatshëm/e për detyra tjera shtesë në rrethana specifike dhe sipas nevojës.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara

- të ketë të kryer nivelin e mesëm të edukimit;
- të posedojë lejën valide të shoferit të kategorisë "B";
- së paku dy vjet përvojë si vozitës profesional në Institucionet Shtetërore ose private, në Organizata Jo-Qeveritare apo në organizata ndërkombëtare;
- të ketë shkathtësi koordinuese;
- përvoja e punës me agjensione ndërkombëtare e preferuar;
- të ketë shkathtësi ndërpersonale të mira dhe të punojë në ekip;
- aftësi të dëshmuara që të punojë në ambiente komplekse multisektoriale;
- i gatshëm të jetë fleksibil në orar të punës me qëllim të arritjes së objektivave të programit dhe të marrë përsipër detyra shtesë nëse kërkohet nga Menaxheri i Programit;
- Njohja e gjuhëve zyrtare të Kosovës.

- CV me tre (3) referenca të verifikueshme dhe kopje të patent shoferit dhe të Diplomës per nivelin e mesem te edukimit te skanuar duhet të dorëzohen në CDF, me e-mail në procurement.hiv.tb@kcdf.org, jo më vonë se 29 Prill 2019 në orën 16:00.

Termat e Referencave për këtë pozicion mund të merren edhe në faqen e internetit të CDF: www.kcdf.org.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për një intervistë.